



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Buletini i aktiviteteve për muajin Korrik 2024

02.07.2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot deputetin e Parlamentit të Republikës së Kroacisë, nga komuniteti rom, Veljko Kajtazi, së bashku me bashkëpunëtorë e këshilltarë si dhe kryetaren e Këshillit të Romëve “Kali Sara” në Kroaci.

Me këtë rast shkëmbyen përvojat në aspektin e respektimit të të drejtave të qytetarëve dhe u njohën me arritjet e romëve në Kosovë, respektivisht në Prizren si dhe në Kroaci. Ky takim është një hap i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit mes komuniteteve dhe për ta rritur pjesëmarrjen e romëve në jetën shoqërore dhe politike.



03.07.2024

Në kuadër të programit “UBT Start-Up School”, Kryetari Shaqir Totaj nënshkroi sot Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin UBT që do të sigurojë projekte të përbashkëta në zhvillimin dhe implementimin e programeve për zhvillim ekonomik, urban dhe industrial të Komunës së Prizrenit dhe aktiviteteve të tjera në interes të përbashkët.

Në këtë projekt, ku janë të përfshirë edhe GIZ-i e ITP-ja, UBT-ja do të ofroj bursa studimi për të gjithë studentët e saj të Komunës sonë që do të përcaktohen me vendim të veçantë, në mënyrë që të kontribuoj në edukimin cilësor të rinisë së Prizrenit, si dhe përmes programit Start-up, do t'i mundësohet të rinjve tanë inovatorë të hapin biznese, duke pasur parasysh potencialin e tyre.



04.07.2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot në një takim kurtuazie gjeneralin e pensionuar të ushtrisë gjermane, ish komandant i KFOR-it gjerman në Prizren gjatë vitit 2004 dhe ish komandant i KFOR-it në vitet 2010-2011, Erhard Bühler i shoqëruar me bashkëpunëtorë.


Gjenerali Bühler, po viziton Kosovën, sidomos vendet ku ka shërbyer, ndërsa Kryetari Totaj e njoftoi për zhvillimin e Komunës së Prizrenit, të arriturat e qeverisjes lokale dhe diskutuan për aktualitetin në nivel shtetëror.



05.07.2024

Një atmosferë e jashtëzakonshme mbrëmë në natën e parë të edicionit të dytë të “Rock and Blues Festival” në Prizren.

□  Performancë e shkëlqyer e grupeve “Henry O’Band”, “Prizren International Band”, “Maya Band” dhe “Metal De Facto” në skenën gjigante në ITP, duke pritur me padurim koncertin e sontëm që fillon në orën 20:00.



08.07.2024

Projekti i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për hapjen e kanaleve për ujitjen dhe kullimin e tokave bujqësore në fshatin Hoçë e Qytetit po vazhdon me sukses, që do t’i përmirësojë kushtet për prodhimet bujqësore dhe cilësinë e tyre.



11.07.2024

Kryetari Shaqir Totaj mori pjesë sot në takimin publik për informimin e bizneseve rreth Zonës Ekonomike, që u organizua nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuadër të hartimit të planit të hollësishëm rregullues “Parku i Biznesit”.

📍● Plani do të jetë në shqyrtim publik deri nesër (12 korrik 2024), në orën 16:00, me ç’rast të gjitha bizneset dhe qytetarët kanë mundësi t’i paraqesin kërkesat, propozimet dhe sugjerimet për mundësinë e ri parcelimit të zonës.



12.07.2024

Po vazhdojnë punimet me intensitet të lartë në ndërtimin e tualeteve publike përballë ndërtesës së Administratës Komunale në Prizren, që zhvillohen në kuadër të aktiviteteve për implementimin e Agjendës së Kontratës Sociale për Komunën e Prizrenit dhe mbështetet nga USAID.



15.07.2024

Rregullimi i parkut te ish Pazari i Bulmetit në Prizren ka qenë i domosdoshëm për ta rigjallëruar këtë hapësirë të gjelbër në qendër të qytetit, që me dinamikën aktuale të punëve, do të jetë në dispozicion për qytetarët së shpejti.

♣ Parku është ri dizajnuar duke shfrytëzuar efektshëm hapësirat, që krijojnë ambient të bukur e tërheqës, si për qytetarët, ashtu edhe për vizitorët e Prizrenit.



16.07.2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot drejtorin menaxhues të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Driton Hetemi dhe udhëheqësen e Njesisë së Sektorit Publik të FKKE-së, Njomza Maraj, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të asbestit në disa vende të caktuara, sipas rregulloreve të MESPI-së për projektet e FKKE-së në Komunën e Prizrenit.

"Do të mundohemi ta bëjmë një zgjidhje në lidhje me këtë çështje dhe së bashku me FKKE-në jemi të përkushtuar për ta siguruar mirëqenien e komunitetit përmes menaxhimit të duhur të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit" - u shpreh Kryetari Totaj.



17.07.2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot kryetaren e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Neime Binaku Isufi me bashkëpunëtorë, kryetaren e OSHP-së, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe kryetarin e KRPP-së, Osman Vishaj, ku, biseduan për bashkëpunimin ndërinstitucional me temën 'Marrëveshjet e fshehta në prokurimin publik'.

Me këtë rast u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit mes Komunës së Prizrenit dhe Autoritetit Kosovar të Konkurrencës që ka të bëjë me çështjet që mund ta shtembërojnë konkurrencën e tregut në Republikën e Kosovës.

Është inkurajuese energjia pozitive që dominoi në këtë mbledhje.



18.07.2024

Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve me asfalt nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, kanë përfunduar punimet në fshatrat Zym dhe Karashëngjergj, në akset ku ka qenë i domosdoshëm intervenimi.



22.07.2024

Mbrëmë filloi edicioni i tretë i Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit në skena të hapura "PrizrenFest", të cilin e hapi Kryetari Shaqir Totaj.

🌐”PrizrenFest” do të jetë për një javë ngjarja më e rëndësishme e qytetit i cili sjell shumë publik nga rajoni e bota, ndërsa, Kryetari Totaj ftoi të gjithë qytetarët që ta përjetojnë këtë festival unik që do të ofroj shfaqje në shumë pjesë të Prizrenit, deri më 28 Korrik.



23.07.2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot një delegacion turk, të udhëhequr nga Kryetari i Ankarasë, Mansur Yavaş, i cili po qëndron për vizitë në Prizren.

Kryetari Totaj, përveç që e njoftoi z. Yavaş për karakteristikat e qytetit dhe mënyrën e jetesës, diskutuan edhe për krijimin e mundësive të bashkëpunimit me kryeqytetin e Turqisë, sidomos në fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, kulturës dhe sportit.

Gjithashtu, Kryetari Totaj shprehu mirënjohjen për Republikën e Turqisë, për mbështetjen e vazhdueshme të Kosovës në ndërtimin e institucioneve dhe forcimin e tyre.



24.07.2024

"Prizrenfest Kids" sivjet solli një dimension të ri dhe të bukur në Festivalin e Teatrove me skena të hapura "Prizrenfest", ku fëmijët me gëzim përjetuan magjinë e shfaqjeve për ta në qendër të qytetit.

✦"Interesimi dhe pjesëmarrja madhe e fëmijëve më lumturuan, meqë arti teatral është i çmuar e i rëndësishëm për komunitetin dhe për zhvillimin e kulturës në përgjithësi" - u shpreh Kryetari Totaj.



25.07.2024

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Adem Morina, vizitoi sot fshatin Planejë, me rastin e përfundimit të tërësishëm të ndërtimit të fushës sportive për futboll, basketboll dhe volejboll në Shkollën Fillore “Vëllezërit Frashëri”.

🏰 Stadiumi, i pajisur me të gjitha pajisjet moderne, ulëset dhe ndriçimin do t’i shërbej jo vetëm nxënësve të shkollës, por edhe komunitetit e sportdashësve të Planejës së Hasit.



26.07.2024

Pas ndërtimit të aneksit në SHFMU "Heronjtë e Lumës" në Vërmicë, kanë filluar punimet intensive për renovimin e tërësishëm të shkollës ekzistuese.

☐ Ky projekt i Drejtorisë Komunale të Arsimit synon të krijojë ambient tërheqës dhe modern për nxënësit dhe stafin arsimor të shkollës.

🔧 Renovimi i shkollës përfshinë përmirësimin e infrastrukturës, sigurimin e kushteve të përshtatshme mësimore si dhe ofrimin e mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve shkollore, që do të ndikoj në përmirësimin e cilësisë së arsimit në këtë shkollë.



29.07.2024

Kryetari Shaqir Totaj, së bashku me kolegët e ekzekutivit, vizituan sot vend punishten në pjesën e epërme të sheshit “Shatërvan”, të cilat punime po avancojnë me dinamikën e paraparë dhe së shpejti ky shesh do të ofrojë një ambient të bukur dhe modern, siç e meriton qendra e Prizrenit.



31.07.2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot në një takim miqësor gazetarin e njohur zviceran të sportit, Rainer Maria Salzgeber, i shoqëruar me miqtë nga Zvicra, Ragip Xhaka, Shaip Kadriaj, Blerim Kabashi me bashkëpunëtorë të tyre, ku diskutuan kryesisht për përpjekjet për zhvillimin e sportit dhe investimet e vazhdueshme në infrastrukturën sportive në Komunën e Prizrenit.

Gjatë bisedës, u ndanë vizione për përmirësimin e kushteve për sportistët dhe krijimin e mundësive më të mira për të rinjtë e qytetit e sportdashësit në përgjithësi.



Kabineti i Kryetarit/Njësia për Komunikim me Publikun